



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në mbështetje me nenin 47, paragrafi (1) pika 6) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 123/12 dhe 123/12) dhe nenin 2, paragrafi (1), pika 29) dhe nenin 64, paragrafi (3) nga Ligji i Bankave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/10, 90/09, 67/10 dhe 26/13), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, miratoi

VENDIM

për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për metodologjinë e përcaktimit të përshtatshmërisë së kapitalit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 50/13)

1. Në Vendimin për metodologjinë e përcaktimit të përshtatshmërisë së kapitalit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 47/12), në pikën 6), paragrafi (1), nënpika 10), nënparagrafi (3) ndryshohet me të ri që thotë:

"- autoriteti gjyqësor, Gjykata Kushtetuese dhe organet tjera gjyqësore dhe institucione të tjera;"

Në paragrafin (1), nënpika 12), paragrafi (3), nënparagrafi (2), nënpika 6) pas fjalës: "organet" shtohen fjalët: "dhe institucionet", dhe fjalët: "Drejtoria e Parandalimit të Larjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit", zëvendësohen me fjalët: "Drejtoria e Intelegjencës Financiare".

Në paragrafin (1), nënpika 18), fjalët: "terrace dhe lozha" zëvendësohen me fjalët: "terrace, lozha ose oborri".

Në paragrafin (1), nënpika 19) në fjalinë e parë dhe të tretë, pas fjalës: "parkim" shtohen fjalët: "ose oborri".

2. Në pikën 15), paragrafi (1), nënpika 6), nënparagrafi (2), pika dhe presja zëvendësohen me presje dhe shtohet nënparagraf i ri që thotë:

"-100% nga rezerva e rivlerësimit e përcaktuar në pajtim me Vendimin për trajtimin kontabël dhe rregullator të aktiveve të konfiskuara bazuar në pretendimet e papaguara;"

Në paragrafin (2) pas fjalëve: "aksione nga", shtohen fjalët: "paragrafi (1)".

Pas paragrafit (2) shtohen dy paragrafe të reja (3) dhe (4) dhe bëhen:

“Rezerva e rivlerësimit nga paragrafi (1) nënpika 6) nënparagrafi 3 të kësaj pike mund të përjashtohet nga shuma e kapitalit shtesë në rastet në vijim:

- vetëm për atë pjesë që lidhet me aktivet e shitura të konfiskuara për të cilat është paraqitur më parë një shumë e rezervës së rivlerësimit, ose vetëm për shumën që është e barabartë me shumën e fitimit pas tatimit për të cilën Kuvendi i bankës ka miratuar vendim të shpërndahet në rezervat ose në fitimin e mbajtur të pashpërndarë, që i plotësojnë kushte nga pika 11), paragrafi (2) dhe (3) dhe pika 12), paragrafi (1), nënpika 2) të këtij vendimi.

Në Vendimin nga paragrafi (3), nënparagrafi (2) të kësaj pike shënohen mjetet e ndërmarra rezerva e rivlerësimit e së cilës lirohet”.

3. Në pikën 182), paragrafi (2), nënparagrafi (1), pika dhe presja zëvendësohen me presje dhe shtohet fjala: “ose”.

4. Në pikën 183), paragrafi (1) fjalët: “mund të” dhe fjala: “vetëm” fshihen.

5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Veriut.

V nr. 02-15/III-4/2013

28 mars 2013

Shkup

**Guvernatori
dhe kryesuesi
i Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë
Димитар Богов**